



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:172572

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06220087

P.nr.84/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues **Sadri Krasniqi**, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore **Donjeta Zenuni**, në çështjen penale kundër të pandehurit N. J., nga ....., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av.Refik Basha, për shkak të veprave penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.814/2024 të datës 14.06.2024 dhe PP.II.nr.1110/2024 të datës 30.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 18.09.2024, me datë 20.09.2024, publikisht shpalli, ndërsa më datën 27.09.2024 hartoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri:

**N.J.** pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati D. dhe ëma J. e lindur F., i lindur më datë ....., në ....., me nr.personal ....., ....., shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i një fëmije, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes jo të mirë ekonomike – përfitues i ndihmës sociale, sipas deklaratës së tij nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

#### I.

Sepse:

Me datë 24.05.2024 deri më datë 29.05.2024, rreth orës 04:00 min, në ....., më saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit D.F., i pandehuri N. J., me qëllim të përvetësimit të pasurisë së kundërligjshme për vete apo personin tjetër, ka vjedhur pasurinë e luajtshme të dëmtuarit ,në atë mënyrë që, e zgjidh një zingjirë, te një derë të vogël, të hyrjes kryesore, hyn

në garazh, e shtynë me forcë , depërton brenda dhe aty merr , një makinë kositëse elektrike, për bari e markës Bosh, një makinë prerëse elektrike, për bari e markës Einhel, një ventilator elektrik me fletë e markës Shtil dhe një komplet pirunë, lugë dhe thika , përsëri me datë 29.05.2024, në mënyrën e njëjtë si më lartë , ka depërtua në garazhe dhe aty ka marrë , një makinë kositëse të kuqe me benzinë, një arkë , me birra –Zajeqar, ku kishte 4 shishe , dhe pak mish të grirë nga frigoriferi, dhe largohet nga aty, në këtë mënyrë të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

## II.

Se gjatë fillimit të muajit korrik 2024, në objektin e varrezave në fshatin Korminjan i Ulët, i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka marrë sende të huaja, në atë mënyrë që, fillimisht ka thyer xhamin e objektit të varrezave dhe duke deportuar me forcë, ka arritur të marrë një lavabo, një çezme të ujit dhe një karrige, të cilat i ka dërguar në shtëpi, me ç’rast i pandehuri me veprimet e tij, të dëmtuarit Z. K., i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

- me çka ka kryer veprën penale ,Vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 1 nënparag.1.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 38, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 ,70 dhe neni 72 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364 dhe 452, të KPPRK-së, të pandehurit të lartcekur, i PËRCAKTON, edhe ate:

- për veprën penale të paraparë si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me gjobë ( të holla) në shumë prej nga 200 € (dyqind euro), dhe dënim me kusht me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t’iu revokuar në dënim me burg efektiv, si dhe

- për veprën penale të paraparë si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me gjobë ( të holla) në shumë prej nga 300 € (treqind euro), dhe me kusht me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën në rast se i akuzuari kryen vepër

tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg efektiv.

- Gjykata duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 76 paragrafi 1 lidhur me parag.2 nënpar.2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPRK-së, të pandehurin N.J. e,

## G J Y K O N

Me dënim kumulativ:

-Me dënim **unik** me burgim në kohëzgjatje prej **pesëmbëdhjetë (15) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej njëzet e katër (24) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg efektiv, dhe

- Dënim **unik** me gjobë në shumën prej **500 € (pesëqind euro)**, të cilën shumë, do ta arkëtoj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në tri këste mujore, në të kundërtën nëse i pandehuri nuk e arkëton këtë dënim me gjobë, i njëjti dënim me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet një ditë burg.

E dëmtuara V. F. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, ndërsa i dëmtuari Z.K., nga f..... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuarit obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të arkëtoj shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, më datat 14.06.2024 dhe 30.08.2023 ka ngritur aktakuzat PP.II.nr.814/2024 dhe PP.II.nr.1110/2024, me anë të së cilave ka kërkuar që ndaj të pandehurit N. J., nga ....., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprave penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzat dhe pas vlerësimit të së njëjtave dhe shkresave tjera të lëndëve konstatoi se të njëjtat janë të bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtave, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të pandehurit për datën 18.09.2024. Në fillim të kësaj seance gjyqësore, gjykata duke pasur parasysh se ndaj të pandehurit në zhvillim e sipër është duke u zhvilluar procedura penale për dy lëndë, në të cilat lëndë kryesi i veprave penale ishte i njëjtë, e po ashtu edhe veprat penale ishin të natyrës së njëjtë, e për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, në kuptim të nenit 34, paragrafi 1 dhe 7 të KPPRK-së, me Aktvendim, bëri bashkimin e lëndëve penale P.nr.84/2024 dhe P.nr.109/2024, në mënyrë që në të ardhmen, për të njëjtat çështje penale të zhvillohet një procedurë penale dhe të vendoset me një aktgjykim, ndërsa numri unik për këto dy lëndë do të mbetet ai më i vjetri, përkatësisht **P.nr.84/2024**. Në të cilën seancë gjyqësore, pas leximit të aktakuzave nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari N.J. ka deklaruar se i ka kuptuar aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale me të cilat ngarkohet.

E dëmtuara V. F. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Prokurorja e shtetit Ilirana Haziri-Kryeziu, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i pandehurit lidhur me veprat penale me të cilat akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, edhe ate pas konsultimit me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i pandehuri N. J., me dashje ka kryer veprat penale, Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, në kohët, vendet dhe mënyrat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilat vepra penale, gjykata të pandehurin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të tjera por ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Iliriana Haziri- Kryeziu me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare ka deklaruar se i propozon gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritator sipas KPRK-së, ashtu që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me peshën e të dy veprave penale për të cilat sot është bashkuar procedura dhe në raport me sjelljen dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që si rrethana lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë për të dy veprat penale, kurse si rrethana rënduese të merr për bazë peshën e veprave penale, shkallën e lartë të dashjes të të pandehurit në kryerjen e veprave penale, natyrën e njëjtë të veprave penale që i ka kryer, pasojat e shkaktuar te të dëmtuarit dhe dëmin material që iu është shkaktuar të dëmtuarve, ashtu që me dënimin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit siç përcaktohet në nenin 38 të KPRK-së.

E dëmtuara në cilësi të dëshmitares ka deklaruar se me të njëjtin janë fqinj dhe se kësaj here kanë vendosur që të mos i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk parashtrojnë kërkesë pasurore juridike dhe se kërkojnë nga i pandehuri që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare av.Refik Basha ka deklaruar se, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale që prokuroria e shtetit ia vë në barrë, kërkon nga gjykata që ndaj të njëjtit me rastin e përcaktimit të sanksionit penal, ta ketë parasysh gjendjen e tij ekonomike tejet të rëndë, gjendjen shëndetësore të fëmijës së tij se është i sëmurë nga epilepsia dhe është i vetmi që duhet në vazhdimësi edhe pas këtyre ngjarjeve të kujdeset për të. Andaj kërkon nga gjykata që ti shqiptoj të pandehurit një dënim sa më të butë duke e shndërruar sanksionin efektiv në kusht ose eventualisht edhe me para që i njëjti në të ardhmen të jetë i vetëdijshëm dhe ti shërbejë si leksion që mos ti përsërisë veprat penale të natyrës së njëjtë.

I akuzuari N. J. ka deklaruar se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të paraqitur nga mbrojtësi i tij, i kërkon falje publikisht të dëmtuarës dhe e falënderon për faljen që e bëri ndaj tij dhe premtion se në të ardhmen nuk do të përsëritet një gjë e tillë dhe kërkon nga gjykata që mundësisht ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti, po ashtu pati parasysh edhe gjendjen e vështirë ekonomike të tij, sepse si mbajtës i familjes jeton në kushte të vështira ekonomike dhe se i njëjti e ka një fëmijë të sëmurë që vuan nga sëmundja e epilepsisë, shih provat si në shkresat e lëndës të lëshuara nga Klinika Universitare në Nish, është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, të dëmtuarës i kërkon falje. Gjykata gjithë ashtu si rrethanë lehtësuese pati parasysh edhe faktin se e dëmtuara në cilësi të dëshmitares V. F. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike. Gjykata po ashtu ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurit është hera e parë që bien ndesh ligjin, premtimi i tij gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, pastaj sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, kërkim falja të dëmtuarës . Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer, dashjen e lartë të të pandehurit dhe mënyrën e kryerjes së saj.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të pandehurit Nikola Jovanoviq, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

E dëmtuara V. F. nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari Z.K., nga ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €(njëzetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2024:172572, 27.09.2024**

Zyrtarja Ligjore,

Gjyqtari i vetëm gjykues,

\_\_\_\_\_  
Donjeta Zenuni,d.v.

\_\_\_\_\_  
Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë.